Mendohu para se të pikturohesh

A je tunduar ndonjëherë të bësh tatuazh? Para se të vendosësh, shqyrto faktorët më poshtë.

ÇFARË MENDON?

Ç'pikëpamje ke për tatuazhet?

- Gjithmonë të përshtatshme
- Gjithmonë të papërshtatshme
- Varet nga motivi ose mesazhi
- Varet nga vendi
- Varet nga madhësia

www.jw.org © 2016 Watch Tower Bible and Tract Society of Pennsylvania

ARSYETO RRETH SHKRIMEVE

Dua një tatuazh, sepse _____

Shkrimi: «Mos bëni prerje në trup për një shpirt të vdekur, e as tatuazhe.»—**Levitiku 19:28.**

E VËRTETË APO E RREME: **Këtij ligji që iu dha izraelitëve, duhet t'i binden edhe të krishterët.**

Përgjigjja:
E RREME.

Të krishterët nuk janë më nën Ligjin e Moisiut. (Hebrenjve 7:18-22) Gjithsesi, Levitiku 19:28 na ndihmon të kuptojmë pikëpamjen e Zotit. Popujt përreth Izraelit bënin tatuazh emrat ose simbolet e perëndive të tyre.

Sipas teje, pse Perëndia nuk donte që izraelitët të bënin tatuazh?

_____

_____

_____

Po në cilat rrethana do të ishte komplet e papërshtatshme që një i krishterë të bënte tatuazh?

_____

_____

_____

www.jw.org © 2016 Watch Tower Bible and Tract Society of Pennsylvania

Është thjesht një mesazh i mirë dhe më kujton një person që e dua.

Shkrimi: «I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për të mësuar, për të qortuar, për të ndrequr dhe për të disiplinuar në drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë krejtësisht i zoti, plotësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.» **—2 Timoteut 3:16, 17.**

Shkrimi: «Por ai që ndalet e shikon në ligjin e përsosur që sjell liri dhe ngulmon në të, është i lumtur ngaqë bëhet zbatues i fjalës dhe jo dëgjues harraq.»**—Jakovi 1:25.**

A mendon se një mesazh pozitiv, si për shembull një thënie a mendim nga Shkrimet, do të ishte i përshtatshëm si tatuazh?

- ◯ **Po, sepse** _____
- ◯ **Jo, sepse** _____

Cila është mënyra më e mirë për të kujtuar parimet dhe urdhërimet nga Shkrimet?

_____

_____

_____

Cilat janë disa mënyra më të mira për të kujtuar njerëzit që duam?

_____

_____

_____

«Si do të ndiheshe po t'i kishe bërë një dhuratë të bukur dikujt dhe ai ta shkarraviste ngado me një stilolaps që nuk fshihet? Po njësoj do të ndihej Krijuesi po të bënim një tatuazh.»
—Ana.

www.jw.org © 2016 Watch Tower Bible and Tract Society of Pennsylvania

Mendoj se duket bukur. Është thjesht art, dhe për më tepër është trupi im.

Shkrimi: «Stolisja juaj të mos jetë e jashtme, domethënë gërshetimi i flokëve, vënia e stolive prej ari ose veshjet e sipërme, por le të jetë njeriu i fshehtë i zemrës me veshjen e paprishshme të frymës së qetë e të butë, e cila ka vlerë të madhe në sytë e Perëndisë.» **—1 Pjetrit 3:3, 4.**

Shkrimi: «Çfarë kërkon në këmbim Jehovai nga ti, veçse të tregosh drejtësi, të duash mirëdashjen dhe të jesh modest ndërsa ecën me Perëndinë tënd?»**—Mikea 6:8.**

Pse mendon se Bibla i jep kaq shumë rëndësi modestisë?

Si mund të ndikojë pamja jote te të tjerët?

NJERËZIT NË PËRGJITHËSI Lexo 2 Korintasve 6:3.	SHOKËT E TU Lexo 1 Korintasve 10:31-33.	PERËNDIA YT Lexo Romakëve 12:1.
Pse ka rëndësi ajo që mendojnë të tjerët për ty?	**Nëse do të bëje një tatuazh, çfarë ndikimi mund të ketë te të tjerët?**	**Pse ka rëndësi për Perëndinë mënyra si e trajton trupin tënd?**

www.jw.org © 2016 Watch Tower Bible and Tract Society of Pennsylvania